

Vazhdimi:  
Përse pavarësi e kushtëzuar?



**VAZHDIMI:**

**\***

**PËRSE PAVARËSI  
E KUSHTËZUAR?**

**INDEPENDENT INTERNATIONAL COMMISSION ON KOSOVO**

Independent International Commission on Kosovo:  
*The follow-up of the Kosovo Report ★ Why conditional independence?*

---

© Independent International Commission on Kosovo

Produced in cooperation with  
the Olof Palme International Center and Global Reporting  
[www.palmecenter.se](http://www.palmecenter.se) and [www.globalreporting.net](http://www.globalreporting.net)

Cover photograph by Paolo Pellegrin

Cover design and typeset by Cecilia Medin, Global Reporting

Printed in Sweden by Tryckeriet Åsbrink Grafiska, Solna, 2001

ISBN 91-87614-11-1

# CONTENTS

Preface

The Follow-up \* Why conditional independence?

Introduction • 9

The context:

Positive and negative developments in the Balkan region • 11

The situation in Kosovo and the illusion of self-rule • 18

Revisiting conditional independence • 22

Towards a regional process • 32

Conclusion • 36

End notes • 39

Acronyms • 40

Background about the Commission • 41

[www.kosovocommission.org](http://www.kosovocommission.org)

## PREFACE

Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën është rezultat i iniciativës së Kryeministrit Suedez, zotëri Goran Persson, për të ofruar një analizë objektive të ngjarjeve para, gjatë dhe pas luftës në Kosovë, dhe për t'i shqyrtuar mësimet e nxjerra nga kjo. Kryeministri Persson kërkoi nga ne (Gjykatësi Richard Goldstone nga Afrika Jugore dhe Sekretari Gjeneral Carl Tham nga Suedia) të kryesojmë sëbashku këtë iniciativë. Ne pastaj i angazhuam edhe 11 anëtarët e tjerë të Komisionit, i cili filloi punën në Shtator të vitit 1999.

Komisioni është i pavarur nga Qeveria Suedeze si dhe nga çfarëdo qeverie dhe institucioni tjetër, nacional apo ndërkombëtar.

Komisioni e ka botuar Raportin për Kosovën: Konflikti, Regjimi Ndërkombëtar, Mësimet e Mësuar (Oxford University Press) në Tetor të vitit 2000. Që nga atëherë anëtarët e Komisionit kanë marrë pjesë në një numër të seminareve, takimeve dhe diskutimeve në lidhje me Raportin dhe konkludimet e tij. Ne dëshirojmë të falënderojmë përkrahjen e madhe që e ka pasur Komisioni, dhe për kohën të cilën na kanë ofruar shumë njerëz të kualifikuar që ishin të inkuadruar në Kosovë drejtëpërsëdrejti. Ne kemi mësuar shumë nga ata.

Komisioni e mbajti mbledhjen e tij të fundit në Stokholm më

8-9 Shtator 2001. Me botimin e kësaj shtese të Raportit, detyra  
jonë përfundon.

Stokholm Shtator 2001

Richard Goldstone  
Carl Tham

# VAZHDIMI: PËRSE PAVARËSI E KUSHTËZUAR?

## HYRJE

Kjo shtesë është shkruar pak para ngjarjeve të tmerrshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës më 11 Shtator 2001. Lufta globale kundër terrorizmit ka krijuar një hije të dendur dhe të rëndë mbi gati të gjitha çështjet tjera ndërkombëtare. Në jemi shumë të brengosur për implikacionet e kësaj për popullin kosovar. Do të ishte një përfundim tragjik i luftës së NATO-s të vitit 1999, po të harrohet edhe njëherë Kosova ose, më keq, nëse Beogradit i lejohej që të pengoj realizimin e vetvendosjes së popullit kosovar. Deklaratat e fundit nga qeveria e RFJ-së nuk janë ngushëlluese. Komisioni ndihet i obliguar t'i përkujton liderët e bashkësisë ndërkombëtare se statusi i Kosovës ende nuk është zgjidhur, dhe se të lihet kjo çështje e pazgjidhur është akt mizor ndaj kosovarëve dhe rrezik për stabilitetin e Ballkanit.



Legjitimiteti i intervenimit humanitar varet jo vetëm nga ajo se çka ndodhë gjatë dhe menjëherë pas intervenimit, por edhe nga programi më afatgjatë. Ata që marrin pjesë në intervenime humanitare e kanë obligim të sigurojnë se veprimet e tyre kontribuojnë në një rezultat stabil dhe produktiv.

*Raporti për Kosovën është botuar nga Komisioni Ndërkombëtar*

për Kosovën (të cilit tash e tutje do t'i referohemi vetëm si “Komisioni”) në Tetor 2000. Dy konkludime kryesore dolën nga ai. Njëri ishte se intervenimi i NATO-s në Kosovë ishte i paligjshëm por legjitim. Ishte i paligjshëm sepse nuk kishte fituar aprovimin paraprak nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara. Intervenimi ishte legjitim sepse në Kosovë ndodhnin shkelje të mëdha të të drejtave të njeriut, sepse të gjitha mundësitë diplomatike ishin harxhuar, sepse Kosova është =liruar si pasojë e intervenimit, sepse shtypja e shqiptarëve nga Kosova përfundoj dhe se të gjithë ata që ishin dëbuar nga forcat Jugosllave gjatë luftës ishin në gjendje të kthehen në shtëpitë e veta. Konkludimi tjetër i Komisionit ishte se Kosovës duhet dhënë statusin e “pavarësisë së kushtëzuar”. Kjo nënkupton një Kosovë vetqeverisëse, jashtë RFJ-së, por në kuadër të një kornize specifike ndërkombëtare, në kuadër të se cilës bashkësisë ndërkombëtare i mbetetet përgjegjësia për sigurinë e kufijve dhe për mbrojtjen e minoriteteve.

Raporti ka shkaktuar një interesim dhe diskutim të madh. Pyetjet më të shpeshta që i'u kanë bërë anëtarëve të Komisionit ishin se a janë rekomandimet e tij ende relevante duke marrë parasysh ngjarjet që kanë ndodhur pas botimit të Raportit. Këto ngjarje përfshijnë:

- Rëzimin e Milosheviqit nga pushteti dhe vendosjen e qeverisë së re në Beograd, të angazhuar për demokraci;
- Përhapjen e dhunës në Maqedoni dhe në jug të Serbisë;
- Krijimin i një kornize të re kushtetuese për Kosovën.

Kritikët e Raportit kanë theksuar se dhuna e vazhdimshme dhe niveli i lartë i krimit në Kosovë, vrasjet hakmarrëse dhe dëbimi i serbëve dhe minoriteteve të tjera, si dhe përhapja e dhunës në regjionet fqinjë e kanë vërë në pyetje legjitimitetin e intervenimit të NATO-s. Gjithashtu është argumentuar se thirrja për “pavarësi të kushtëzuar” nuk është më urgjente pasi që është rëzuar diktatura brutale në Beograd dhe se, mëtutje, çfarëdo diskutimi rreth

statusit përfundimtar të Kosovës do ta destabilizon procesin delikat të demokrazimit në Serbi. Realisht, ngjarjet e periudhës pas intervenimit i kanë kthyer anasjelltas perceptimet standarde ndërkombëtare të simpatisë për shqiptarët e Kosovës dhe të antipatisë për serbët.

Duke marrë parasysh këto kritika dhe zhvillime, Komisioni vendosi të shkruaj një shtesë të Raportit. Qëllimi ynë është që të vlerësojmë rëndësinë e propozimeve tona të para duke marrë parasysh situatën e ndërruar në Ballkan, të pyesim se a mundet intervenimi i NATO-s ende të konsiderohet legjitim duke marrë parasysh zhvillimet pas intervenimit, dhe se a është propozimi ynë për “paravësi të kushtëzuar” ende me vend. Do të fillojmë dukë përshkruar ngjarjet pozitive dhe negative në rajon që kanë ndodhur pas botimit të Raportit. Pastaj do ta shqyrtojmë situatën në vet Kosovë dhe posaçërisht implikacionet e kornizës kushtetuese. Kaptina e tretë do ta rishqyrton dhe zhvillon propozimin për pavarësi të kushtëzuar, përdërisa kaptina e katërt do t’i diskutojmë mekanizmat për këtë proces-se si mund të arrihet pavarësia e kushtëzuar- si dhe nevojën për një kornizë regionale.

## **KONTEKSTI: ZHVILLIMET POZITIVE DHE NEGATIVE NË RAJONIN BALLKANIK**

Një fenomen pozitiv është rënia e nacionalizmit ekspansionist dhe militant nga pushteti. Pas një dekade në të cilën agjendat politike Ballkanike ishin të dominuara nga radikalët etno-nacionalistë, rënia e Millosheviqit është përputhur më ardhjen në pushtet të jonacionalistëve dhe/ose nacionalistëve të moderuar në rajon, të cilët favorizojnë ndërrime demokratike dhe të cilët shikojnë kah Perëndimi, sidomos drejt Bashkësisë Evropiane (BE-së), për mbështetje dhe inspirim politik. Në Beograd, Vojislav Koshtunica është duke kryesuar një tranzicion të paqartë: demokracia, ligji dhe mediat e pavarura janë avansuar dukshëm, por

struktura (dhe personeli) nga aparati ushtarak dhe policor i regjimit të vjetër vazhdon të jetë edhe më tutje në pozitë. Mëtutje, lidhja e popullatës dhe e qeverisë serbe me Kosovën, si simbol i aspiratave nacionale serbe, vazhdon të jetë e fortë. Bartja e Millosheviqit në Hagë për gjykim nga Tribunali Ndërkombëtar për Krime në Ish Jugosllavi (TNKJ) është bërë në rend të parë për arsye ekonomike (që të mundëson marrjen e ndihmës Perëndimore) dhe, natyrisht, për t'iu shmangur gjykimin vendor. Sidom, zbulimi i varrezave masive në Serbi ka nxitur të të menduarit mbi të kaluarën e Serbisë që mund të kontribuojë në mënyrë të rëndësishme procesit të demokratizmit, edhe pse ende ekziston reziku i një reacioni nacionalist. Ardhmëria kushtetuese e Jugosllavisë është ende e paqartë, sidomos pas fitores së koalicionit malazias për pavarësi, edhe pse dallimi në vota ishte i vogël.

Kroacia është distancuar edhe më qartë nga qeverisja autoritare e kryetarit të ndjerë Franjo Tugjman, dhe nga programet ekstreme nacionaliste. Kryetari Stipe Mesiq në mënyrë të qartë është deklaruar për një bashkëpunim me Tribunalin Ndërkombëtar për Krime Luftë. Arrestimi i Gjeneralit Mirko Norac, përkundër demonstrarave masive në Split, ishte një akt i guximit politik që gati se fare nuk u njoh në kryeqytetet Perëndimore. Akt i guximshëm ishte poashtu edhe distancimi i tij nga ultranacionalistët në Hercegovinë të cilët (me përkrahjen e HDZ-së në Zagreb) cenonin implementimin e Marrëveshjes së Dejtonit. Më në fund, nën udhëhqjen e Mesiqit, Kroacia ka vendosur të lejojë kthimin e serbëve të dëbuar nga Krajina gjatë verës së vitit 1995.

Në Bosnje dhe Hercegovinë gjithashtu ka pasur zhvillime premtuese. Koalicioni i jonacionalistëve dhe nacionalistëve të moderuar, Aleanca për Ndryshim, ka ardhur në pushtet pas zgjedhjeve të Nëntorit 2000. Social Demokratët janë tani partia më e madhe në Federatë, duke zëvendësuar kështu partinë muslimane nacionaliste të ish-Kryetarit Alija Izetbegović, Partinë e Aksionit Demokratik (SDA). Edhe në Republikën Serbe qeveria e Milan

Ivanoviqit duket se është e angazhuar për reforma demokratike, transparencë dhe drejtësi. Kthimi i refugjatëve është shpeshtuar, duke përfshirë këtu edhe zonat të cilat nuk i kontrollon grupi i tyre etnik. Mirëpo, retorika e kooperimit me ТНКЈ ende nuk është e përcjellur me vepra.

Si shtesë e gjithë kësaj është moderimi i qëndrueshëm i Bullgarisë, edhe pse mbetet të shihen pasojat e zgjedhjes së ish-mbretit për pushtet dhe të luftës në Maqedoni. Qasja e Greqisë ndaj tërë rajonit, sidomos Maqedonisë, është dita ditës më konstruktive- qasje e ndikuar shumë nga Ministri i Jashtëm George Papan-dreou. Ky ndërrim, që dallon nga qasjet nacionaliste të qeverive të mëparshme, është shumë i mikëpritur. Qeveria socialiste në Shqipëri gjithashtu i ka mikëpritur ndërrimet në Beograd dhe sër-ish ka theksuar përkrahjen e saj për integritetin e kufijve dhe opozitën e saj ndaj dhunës. Andaj, situata pas betejave Ballkanike duket më pozitive se kur është shkruar Raporti; në përgjithësi, rajoni duket i gatshëm që t'i kthehet demokracisë, stabilitetit rajonal dhe integritetit.

Por, edhe pse duket se projekti i nacionalizmit ekspansionist, shkaktarit të luftërave ballkanike, është mundur në nivel qeveritar, pasojë e luftërave është një trashëgim i ndjenjave ekstremiste tek masat. Traumata e luftërave kanë lënë pas gjurmë të frikës dhe pasigurisë, fajësisë dhe mosbesimit-ndjenja që nuk mundën lehtë të largohen e të cilat ushqehen nga ndjenja e sigurisë që fitohet nga identifikimi etnik. Mëtutje, ekonomia e Ish-Jugosllavisë është shkatërruar nga lufta dhe shpartallimi i Jugosllavis. Bruto Prodhimi Vendor (BPV) ka ra ashpër, dhe papunësia ka mbërritur nivele të papara- në shumë zona papunësia ka arritur edhe 40%-50%. Një ekonomi joformale ilegale, e lidhur me rrjeta kriminale dhe grupe paramilitare përgjatë rajonit, është konsoliduar gjatë luftërave dhe shume njerëz janë ende të varur nga një llojllojshmëri e aktiviteteve joformale të cilat, deri tani, kanë qenë të "mbrojtura" nga partitë nacionaliste. Dhe më në fund, shoqëria civile dhe forcat politike jonacionaliste janë dobësuar nga lufta.

Një lloj i politikës demokratike filloi të zhvillohej në Jugosllavi gjatë periudhës 1990-2, sidomos nëpër qytete. Mirëpo, këta individë urban, jofetar dhe të arsimuar, që formonin bazën e politikës potenciale demokratike, u shpërngulën ose në disa raste u vranë, siç ndodhi në Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi.

Kjo trashëgimi e nacionalizmit tek masat është e pasqyruar në fuçinë e mëtutjeshme të partive nacionaliste në disa zona. Partitë në pushtet në Beograd kanë bërë kampanjë në një platformë nacionaliste, megjithëse demokratike. Në Kroaci HDZ-ja pat rezultat të mirë në zgjedhjet e fundit lokale. Në Bosnje dhe Hercegovinë, përkundër suksesit të Social Demokratëve, vëzhguesit ndërkombëtarë ishin të dëshpruar me përqindjen që partitë nacionaliste ende fitojnë në zgjedhje. Në Mal të Zi partitë për pavarësi vetëm sa e fituan shumicën në zgjedhjet e Prillit të 2001. Ndërkohë, fitorja e partisë nacionaliste maqedone VMRO dhe partisë radikale shqiptare DPA në Nëntor 1998, pas viteve të qeverise Social Demokratë (edhe pse nacionaliste), paraqet një pjesë të rëndësishme të tregimit të konfliktin që po shpaloset në Maqedoni.

Më alarmante janë megjithate persistenca e incidenteve, protesteve, madje edhe dhunës nacionaliste. Më parë u përmendën demonstratat në Split. Në territorin e Bosnjës, ka pasur demonstrata violente në Hercegovinën perëndimore kundër përpjekjeve ndërkombetare për t'i shpërbërë strukturat e pushtetit nacionalist. Dhunë pat gjithashtu në Republikën Serbe kur bashkësia muslimane u mundua të vendosë themelet për rindërtimin e xhamive të shkatërruara gjatë luftës. Me rast të kthimit të refugjatëve dhe të të zhvendosurve poashtu ka pasur incidente, si dhe gjatë përpjekjeve për rindërtimin e simboleve fetare apo kulturore.

Mbi të gjitha, dhuna në jug të Serbisë dhe në Maqedoni sygjeron se “Çështja Shqiptare” është larg zgjidhjes. Në jug të Serbisë Ushtria Çlirimtare e Preshevës, Medvegjës dhe e Bujanocit (УÇРМБ) u paraqit në fillim të vitit 2000. Këto tri rajone ishin

shkëputur nga Kosova pas Luftës së Dytë Botërore, përderisa disa zona serbe nga jugu i Serbisë i'u bashkangjiten Kosovës. Arsyerja e dhënë për këtë kishte të bëjë vijat e komunikimit me Greqinë, Shqipërinë dhe Turqinë; mirëpo, pasojë e kësaj ishte zvogëlimi i popullatës shqiptare në Kosovë. UÇPMB-ja u zhvillua, si edhe grupet e tjera të armatosura, në Zonën Tokësore të Sigurisë (ZTS), të formuar pas hyrjes së NATO-s në Kosovë në Qershor të vitit 1999. Kjo zonë ka pasë për qëllim ndarjen e trupave të NATO-s nga ato Jugosllave, dhe nga Serbia dhe Mali i Zi vetëm policia e armatosur lehtë kanë qenë e lejuar në këtë zonë. Pas 5 tetorit 2000, qeveria e re serbe hyri në negociata me UÇPMB-në dhe NATO-n; u arrit një marrëveshje e cila u jipte shqiptarëve vendorë drejta më të mëdha, mundësonte demobilizmin, çarmatimin dhe integrimin e luftëtarëve të mëparshëm në forcat lokale të sigurimit, dhe lejonte hyrjen e forcave Jugosllave në ZTS.

Marrëveshja e Preshevës paraqet një model se si mund të realizohen negociata të tilla. Elementet kyçe për sukses ishin vullneti politik i qeverisë Serbe për të arritur deri te marrëveshja, presioni i NATO-s mbi palën shqiptare, pjesëmarrja e përfaqësuesve të grupeve të armatosura si dhe të shqiptarëve vendorë në këtë proces, dhe besimi i ndërsjellë i të gjitha palëve në marrëveshje. Rëndësi të posaçme ka pasur përpjekja e qeverisë serbe që të konsultohet dhe bisedon me një numër të madh të njerëzve që jetonin në atë rajon: kjo qasje prej masave deri te elitat që e parapriu marrëveshjen është një inovacion më rëndësi vendimtare për marrëveshjet paqësore tjetërkundi. Mirëpo, në afat të gjatë, sukcesi i marrëveshjes do të varet nga implementimi i saj efektiv.

Situata në Maqedoni dallon dukshëm nga kjo. Si edhe UÇPMB-ja, Ushtria Çlirimtare Kombëtare është formuar në ZTS dhe, si UÇPMB-ja, përmbante shumë veteranë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Një numër i shqiptarëve nga Maqedonia ishin anëtarë të Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK), partia majtiste e cila së pari e kishte krijuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe cila kishte qasje tek paratë e diasporës kosovare nëpërmes fondit Vendlindja

Thërret (shih Kapitullin 1 të *Raportit për Kosovën*). Si në rast me UÇPMB-në, pyetje serioze janë shtruar rreth mundësisë së zhvillimit të grupeve guerile shqiptare brenda ZTs dhe se pse furnizimi nuk është penguar nga KFOR-i. Është sugjeruar se kjo ka qenë e qëllimshme; se amerikanët dëshironin ta destabilizonin Serbinë jugore para 5 tetorit 2000. Ky është një spjegim i pranuar si nga qarqet serbe ashtu edhe nga ato shqiptare; tek shqiptarët kjo kontribon në ndjenjën se amerikanët “janë me ne” dhe se është mundur të veprohet pa ndëshkim. Një spjegim shumë më realistik është se këto zhvillime janë pasojë e dëshirës që të mos rezikohen forcat paqeruajtëse. Pasi që një proporcion shumë i madh i KFOR-it është i angazhuar për “mbrojtjen e forcave” nuk ka resurse të mjaftueshme për ngritjen e sigurise publike.

Ekzistojnë shumë arsye se pse në Shkurt të vitit 2001 filloi dhuna në Maqedoni: që ky shpërthim i dhunës ka pasur për qëllim mbrojtjen korridoreve të shvercit me cigare ose të depos së armëve të penguar nga marrëvsheja serbo-maqedonase për finalizimin e kufirit; ose se ishte provokim nga ish-paramilitarët jugosllav në rajon; ose, se tani që Kosova është në rrugë drejt zgjidhjes së problemit të saj ishte koha të mirremi me të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni dhe se dhuna është treguar shumë më efektive se metodat paqësore në tërheqjen e vëmendjes në probleme. Çkado që ishte arsyeja e shkrepjes së parë, përhapja e dhunës ishte shumë më e shpejtë se që ndokush e kishte paramenduar. Qeveria e tashme maqedonase është ajo e koalicionit në mes të VMRO-së dhe DPA-së. Para zgjidhjeve të nëntorit 1998, të dy partitë theksonin pozitat e tyre ekstreme. VMRO-ja ndonjëherë favorizonte një shtet të pastër etnik; përderisa DPA-ja favorizonte federalizmin e Maqedonisë, më një pjesë të ndarë perëndimore nën kontrollë shqiptare, të quajtur “Ilirida”. Kur e formuan koalicionin të dyja palët e qetësuan pak retorikën e tyre. Situata në Maqedoni nuk ka qenë fare e ngjajshme me atë të Kosovës gjatë regjimit të Millosheviqit para intervenimit të NATO-s. Maqedonia ishte një polit demokratik edhe pse shqiptarët, që përbejnë rreth një të tretën e

popullatës, ndiheshin si qytetarë të klasës së dytë. Ata kishin disa arsye të mira për këtë: kushtetuta maqedonase deklaroi se Maqedonia është shtet i popullit maqedon (dmth i sllavëve); gjuha zyrtare është maqedonishtja, dhe nuk ka gati kurfar arsmimi i mesëm ose i lartë në gjuhën shqipe; gjithashtu ka shumë pak shqiptarë në administrimin publik, sidomos në armatë dhe polici.

Situata në Maqedoni gjithashtu dallon nga ajo në Luginën e Preshevës. Për dallim nga Serbia, qeveria maqedonase, me përkrahjen e qeverive Perëndimore, i është përgjigjur dhunës me një strategji klasike kundër revolucionare- pra me bombardimin dhe granatiminin e fshatrave, kur mendohej se Ushtria Çlirimtare Kombëtare ishte e vendosur, e kombinuar me arrestimin dhe torturimin e pohuar të civilëve shqiptarë me qëllim të identifikimit të anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare<sup>2</sup>. Pasojë e kësaj ishte përkrahja e popullatës shqiptare, dhe gjithashtu e partive politike shqiptare të cilat janë munduar që t'i plotësojnë kërkesat shqiptare (me pak sukses) në mënyrë paqësore, dhënë lëvizjes së Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Kishte zhvendosje të qëllim të popullatës nga të dy anët, ku diku rreth 120,000 njerëz janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre. Rreth 80,000 refugjatë u strehuan në Kosovë. Në gusht 2001 marrëveshja paqësore u arrit nga bashkësia ndërkombëtare, e cila në fillim të shtatorit nën presion ndërkombëtar u aprovua nga parlamenti maqedon; forcat e NATO-s janë dërguar në Maqedoni për t'i mbledhur armët e dorëzuara vullnetarisht nga Ushtria Çlirimtare Kombëtare. Që nga atëherë diku rreth 50,000 refugjatë janë kthyer në Maqedoni. Përderisa marrëveshja i përmbushë shumicën e kërkesave shqiptare, metodat e përdorura për t'u arritur deri te marrëveshja nuk premtojnë shumë të mira për besim dhe bashkëpunim të ndërsjellë në mes të dy bashkësive në të ardhmen. Dhuna e përdorur nga ana e guerilëve shqiptarë dhe kundërdhuna e ushtruar e kanë dobësuar besimin e duhur për vazhdimin e një shteti të bazuar në bashkëjetesë të dy bashkësive të ndryshme.

Gjithashtu nuk mundemi të kemi besim të madh mbi pros-

pektin e kontrollimit të dhunës. Siç kemi mësuar gjatë dekadës së kaluar, dhuna në këtë pjesë të botës është ngjitetëse. Ajo përhapet si rezultat i pasigurisë për status dhe kufinjë, me anë të aktiviteteve kriminale dhe rrjeteve paramilitare, nëpërmes refugjatëve dhe të të zhvendosurve, dhe për shkak të sjelljeve predatore të shteteve fqinje dhe një numri të “enterprenerëve të konfliktit”<sup>3</sup>. Shumë nga faktorët që sollën dhunën në Maqedoni- niveli i lartë i papunësisë, kontrabanda dhe aktivitetet e tjera ilegale, pastaj pasiguria dhe pakënaqësitë etnike-ekzistojnë edhe në pjesë të tjera të rajonit, si për shembull në Mal të Zi.

## **SITUATA NË KOSOVË DHE ILUZIONI I VETQEVERISJES**

Situata në Kosovë është poashtu e karakterizuar me zhvillime pozitive dhe negative. Zgjedhjet e para të lira komunale që u mbajtën në tetor të vitit 2000 u mbajtën në mënyrë jashtëzakonisht paqësore. Lishja Demokratike e Kosovës, partia e moderuar nën udhëheqjen Ibrahim Rugovës, fitoi bindshëm, kryesisht sepse elektorati i refuzoi pasardhësit e UÇK-së të udhëhequr nga Hashim Thaqi, që mbesin të asocuar me nivelin e lartë të krimit dhe të dhunës në Kosovë. I Dërguari i ri i Posaçëm i Sekretarit Gjeneral (DPSC), Hans Haekkerup, ka nxjerrur një kornizë kushtetuese e cila do të mundësojë mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme, të caktuara për nëntor të vitit 2001. Qeveria e re serbe është duke bashkëpunuar me UNMIK-un; zyra e UNMKU-t është hapur në Beograd, ndërsa në Prishtinë është formuar Komiteti për Bashkëpunim Jugosllav më Kosovë. Gjithashtu ekstremistët serbë janë marginalizuar (fondet për grupet paramilitare të Mitrovicës, për shembull, janë ndërprerë) dhe serbët kanë marrë përkrahje më të madhe për të participuar në jetën politike kosovare. Shërbimi policor ndërkombëtar si edhe ai vendor janë të konsoliduar tani dhe sistemi juridik është në formim e sipër. Ekonomia është duke u ripërtirë; të ardhurat vendore paraqesin rreth 70 % të buxhetit kosovar për 2001, dhe përkrahja e disaporës

për rindërtim ka qenë diku dyfish më e madhe se shumica e donacioneve zyrtare.

Mirëpo, ana negative është se krimi dhe dhuna janë ende në shkallë të paparaneshme, edhe pse niveli i saj është stabilizuar. Dhuna etnike është zvogëluar, pikësepari se tani gati të gjithë serbët jetojnë nëpër enklava dhe se rrjedhimisht liria e tyre e qarkullimit është e kufizuar. Mitrovica tani është e ndarë politikisht edhe ekonomikisht. KFOR-i është treguar njëkohësisht i paafat dhe pa vullnet për të ndaluar dhunën kontinuale ndaj minoritetëve etnike. Kjo është dështimi më i madh që nga intevenimi i NATO-s i cili, përkundër vështirësive evidente, duhet të kuptohet si një dështim moral. Ende ka shpërthime të protestave dhe dhunës nacionaliste, sidomos në Mitrovicë ku "rojet e urës" në anën serbe e sigurojnë ndarjen e qytetit. Liderët politik shqiptarë kosovarë e lajnë gojën me fjalime kundër dhunës, mirëpo nuk kanë bërë ndonjë punë reale për t'a kontrolluar dhunën, si për shembull duke bërë në anëtarë të rëndomtë të partive për fillimin e një dialogu dhe bashkëpunimi të mirëfilltë me serbët, ose në përgjithësi që të provojnë të krijojnë një atmosferë tjetër. Mbi të gjitha, liderët kosovarë shqiptarë duken ambivalentë në lidhje me dhunën në Maqedoni dhe në jug të Serbisë, dhe janë treguar jo të gatshëm për të dënuar publikisht UÇPMB-në dhe Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare. Përfundimisht, numri i zyrtarëve të papunëve mbetet e lartë, diku rreth 50%. Aktiviteti ilegal ekonomik është gjithashtu shumë i lartë, duke filluar prej ndërtesave pa leje e deri te reketet dhe kontabanda. Këto aktivitete ilegale dëbojnë investuesit nga Kosova, qoftë ata ndërkombëtarë apo vendorë.

Që nga fillimi i UNMIK-ut dhe KFOR-it në qershor 1999, paqartësia rreth statusit final të Kosovës ka krijuar tension ndërmjet përfaqësuesve politik vendor dhe të bashkësisë ndërkombëtare, si dhe brenda vet bashkësisë ndërkombëtare, siç theksuam në Raportin tonë. Rezoluta e KB-së 1244 ka dhënë për detyrë UNMIK-ut të pregatisë Kosovën për një autonomi substanciale dhe vetqeverisje brenda RFJ-së, bile duke paraparë një prezence

policore të RFJ-së në Kosovë. Mirëpo, duke marrë parasysh se ç'përjetoj popullata kosovare në duar të autoriteteve serbe dhe jugosllave-refuzimin e të drejtave të njeriut, sulme mbi fshatra, masakrime dhe më në fund dëbim masiv- nuk ishte kurrë reale të pritet ushtrimi i sovranitetit të RFJ-së mbi Kosovën pas ardhjes së trupave të NATO-s në qershor 1999. Gjithashtu, autonomia substanciale dhe vetqeverisja ishin të pranueshme për shqiptarët vetëm si një stacion gjatë rrugës për një lloj pavarësie. Brenda vet UNMIK-ut, dhe brenda bashkësisë ndërkomëbtare në përgjithësi, kishte përçarje në mes të atyre që besonin se administrata e KB-së është një instrument tranzitor që do të përgatiste kosovarët për vetqeverisje, dhe të atyre që e shihnin UNMIK-un si një protektorat afatgjatë. Gjatë vizitave të shumta bërë Kosovës, Komisionit i la përshtypje qëndrimet e vazhdueshme të përbuzjes imperialiste nga ana e disa elementeve të administratës ndërkombëtare, në lidhje me kapacitetin vetqeveritës të kosovarëve.

Korniza Kushtetuese për Vetqeverisje të Përkoshme, e nxjerrë nga DPSG Hans Haekkerup në maj 2001, pas konsultimeve të kufizuara me faktorët politik vendor<sup>4</sup>, përcakton rregullat për Kosovën para zgjedhjeve kosovare në nëntor 2001 dhe mëpas. Korniza kërkon formimin e asamblesë më përfaqësimit të garantuar për minoritete; kryetarin, e zgjedhur nga asambleja; dhe kryeministrin e qeverisë të zgjedhur nga presidenti. Qeveria e Kosovës ka autoritet mbi çështjet vendore- ekonominë, arsimin, transportin, administratën lokale, gjykatën, burgjet dhe mediat- por ky autoritet është i përkufizuar nga një numri i madh i fuqive të rezervuara për DPSG-në. DPSG-ja ka fuqi të shpërbëjë asamblesën dhe të thirrë zgjedhje të reja, të përcakton "parametrat e gjërë financiar dhe programor" për buxhet, të cakton dhe ndërron gjykatësit dhe avokatët, të kontrollojë Forcat Mbrojtëse të Kosovës, Drejtoratin Doganor, Drejtoratin për Pasurinë Banesorë dhe Pronës, të caktojë të gjithë zyrtarët e lartë ekonomik, të mbikqyrë të gjitha marrëdhëniet e jashtme dhe të bashkëpunojë me KFOR-in në lidhje me sigurinë e brendshme dhe atë kufitare.

Fuqitë ekstenzive të DPSG-së do të thonë se, në vend të një vetqeverisjeje substanciale të premtuar kosovarëve sipas Rezolutës 1244, ata do të kenë një autonomi shumë të kufizuar. Ata do ta kenë iluzionin, e jo realitetin, e vetqeverisjes. Provizionet kushtetuese e vëvë në pah një mosbesim të theksuar të ndërkombëtarëve ndaj aftësive administrative dhe politike të popullit. Por, në qoftëse popullit nuk i besohet atëhere ata do të reagojnë në mënyrë të njëjtë. Komisioni beson se populli nuk do të sillet në mënyrë të përgjegjëshme nëse atyre nuk u lejohet të marrin përgjegjësi. Ka arsye të mendohet se, pasi që që të zgjedhet kryetari, kryeministri dhe qeveria në zgjedhjet e nëntorit 2001, do të krijohen kushtet për një konflikt rreth fuqive të rezervuara të DPSG-së, si dhe në përgjithësi në mes të elitës politike vendore në një anë, të përkrahur nga elektorati i tyre, për fuqi edhe më të madhe vetqeverisëse dhe të bashkësisë ndërkombëtare në anën tjetër, e vendosur në mbajtjen e fuqive të saj. Është e mundur se konflikti që ka një kohë që zhvillohet në mes mënyrës se si e kuptojnë kosovarët dhe ndërkombëtarët vetqeverisjen, të shëndërrohet në një krizë kushtetuese e cila do ta ndalojë zhvillimin afatgjatë ekonomik dhe shoqëror kosovar.

Situata e pazgjidhur në Kosovë ka poashtu pasoja të jashtme. E ashtuquajtura “çështja shqiptare” i referohet faktit se shumica e popullatës shqiptare pas Luftës se Dytë Botërore u gjend jashtë Shqipërisë, kryesisht në atë çka atëherë ishte Jugosllavia. Sot ka diku rreth 400,000 shqiptarë në Serbi, afro 2 milion shqiptarë (90% e popullatës) në Kosovë, diku rreth 600,000–700,000 (popullata e përgjithshme në Maqedoni është diku rreth 2 milion) dhe 40,000 shqiptarë në Mal të Zi. Në vet Shqipëri rreth 95% të popullatës 3.5 milionëshe janë shqiptarë. Edhe pse gjate periudhës komuniste ndoshta ka pasur ëndrra për një Shqipëri të madhe, këto ëndrra janë shkatërruar kur u pa realiteti, sidomos pas luftës në 1999, kur shumë shqiptarë nga Kosova e kaluan luftën si refugjatë në Shqipëri. Përjetimi i shqiptarëve që kanë jetuar në Ish-Jugosllavi, e cila ishte relativisht liberale, dhe të cilët ishin shpesh

gastarbeiter në Evropën Perëndimore, dallon radikalisht nga eksperiencia e shqiptarëve të Shqipërisë, të cilët kanë jetuar në shoqërinë më Staliniste/Maoiste në Evropë. Edhe pse shumë serbë dhe maqedonë besojnë se qëllimi i shqiptarëve është Shqipëria e Madhe, shumica e shqiptarëve, duke përfshirë edhe luftëtarët guerilë, theksojnë se qëllimet e tyre janë Kosova e pavarur, të drejtat shqiptare në Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi, dhe kufijtë e relativizuar që do të mundësonin lëvizjen më të lirë të shqiptarëve dhe takimin e tyre me familjet të cilat tani gjenden në shtete të ndryshme. Ata shpesh e japin si shembull rastin e Gjermanisë, Zvicrës dhe Austrisë, ku një numër i madh i tyre kanë jetuar.

Pasiguria për statusin e ardhshëm të Kosovës sugjeron se çështja shqiptare akoma nuk është zgjedhur që rrjedhimisht e lë çështjen e kufijve të hapur. Larg asaj që pavarësia e Kosovës të luaj rol in e dominos, siç është sugjeruar nga disa, sepse nxitë dëshirën për autonomi teritoriale në rajone të tjera, pasiguria për të ardhmen do të thotë se është ende loja e hapur dhe se ende jugu i Serbisë dhe Maqedonia mund të hyjnë në shqyrtime po qe se faktet në terren ndryshojnë. Me fjalë të tjera, konfliktet e fundit mund të kuptohen si pasojë e pasigurisë, që nxitë përpjekjet për të ndërruar faktet në terren para se të arrihet marrëveshja përfundimtare. Pasiguria dhe jostabiliteti luajnë rolin e faktorëve që mund të quhen “mekanizma ngjites”.

## **RISHQYRTIMI I PAVARËSISË SË KUSHTËZUAR**

Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nuk e përcaktoj ardhmërinë afatgjate për Kosovën. Argumenti për pavarësi të kushtëzuar ka themele normative: pra, se e drejta për vetvendosje rrjedhë nga abuzimi sistematik i të drejtave të njeriut të shqiptarëve të Kosovës gjatë një periudhe të gjatë kohore, që rezultoj në mospajtimin e shqiptarëve të Kosovës me regjimin serb. Në Raport, Komisioni gjithashtu konsideroj katër opsione

tjera për Kosovën: partitionin, protektoratin indefinit, pavarësinë e plotë dhe autonominë brenda një Jugosllavie demokratike. Është sugjeruar se zhvillimet e jashtme dhe të brendshme të përshkruara më parë dhe klima e ndërruar politike i bënë këto opsione më të favorizuara zgjedhje të mundshme për Kosovën. Mendimi ynë, megjithatë, është se konteksti i ndryshuar nuk e ndryshon argumentin normativ për pavarësi të kushtëzuar. Gjithashtu, duhet marrë parasysh se konteksti nuk është stabil dhe se rrethanat mund të ndërrojnë përsëri. Andaj, Komisioni ka ra në përfundim se arsyet për të refuzuar katër opsionet alternative janë ende valide, dhe se bile ato mund të kenë edhe më shumë arsyetim krahas zhvillimeve të fundit në rajon. Vlen që këto arsye t'i përmbledhim shkurtimisht:

**PARTICIONI** \* Ky opcion është sugjeruar kohëve të fundit sërish, posaçërisht nga zëvendës kryeministri i Serbisë Nebojska Qoviq. Ai ka propozuar që Kosova të ndahet dhe se veriu i Kosovës të jetë një entitet i ngajshëm me Republikën Serbe. Ne në Raport i kemi cekur arsyet principiale kundër particionit: një opcion i tillë to të kundërshtonte "Angazhimin normativ të bashkësisë ndërkom-bëtare për t'i ikur zhvendosjes së popullatës dhe për të mbështetur karakterin e përzier dhe multietnik të Ballkanit" (f.267). por ka edhe arsye praktike: ky opcion kurrë nuk do të pranohej nga shumica e popullatës shqiptare e cila e sheh, me të drejtë apo pa të drejtë, kompleksin minator të Trepçës në veri të Kosovës si pjesë e trashëgëmisë elementare të Kosovës. Gjithashtu particioni mundet shumë lehtë të nxitë rifillimin e dhunës në Luginën e Preshevës, me qëllim të ndërrimit të Mitrovicës për Preshevë.

**PROTEKTORATI INDEFINIT** \* Ky është opcion i nënkuptuar nga korniza e re kushtetuese. Ky opcion është i papranueshëm për shkak të të gjitha arsyeve që i përmendëm më lartë. Përderisa ky protektorat indefinit do ta largonte pasigurinë nëse pavarësia do të eliminohej si opcion, tensioni ndërmjet administratës ndërkom-

bëtare dhe kërkesave kosovare për vetvendosje mundën shumë lehtë të arrijnë pikën e thyerjes.

**PAVARËSIA E PLOTË** \* Përderisa dhuna politike vazhdon si brenda Kosovës, ashtu edhe në rajonet fqinje, opcioni i pavarësisë është i parealizueshëm. Thjeshtë, pavarësi e plotë në kontekstin e tanishëm do të ishte e papranueshme si për minoritetet ashtu edhe për shtetet fqinje, dhe do të kishte shumë pak shansë se do të aprovohej nga Këshilli i Sigurimit i KB-së, në autoritetin e të cilit mbështetet statusi momental i padefinuar.

**AUTONOMIA BRENDA RFJ-SË DEMOKRATIKE** \* Zhvendosja e Milosheviqit nga pozita e bën opcionin e katërt më atraktiv edhe për Beogradin si dhe bashkësinë ndërkombëtare. Një opcion që momentalisht po diskutohet është ai i “tre republikave”, ku Kosova do të bëhej republikë me status të barabartë me Malin e Zi dhe Serbinë në Jugosllavi; Rezoluta 1244 referohet në sovranitetin e Jugosllavisë e jo të Serbisë, që hap mundësinë e ndarjes së Kosovës nga Serbia por jo edhe nga Jugosllavia. Natyrisht, kjo mundësi varet nga ajo se çka ndodhë në Mal të Zi. Pas fitores së ngushtë të partive për pavarësi në Mal të Zi në prill 2001, ekzistonte mundësia reale e pavarësisë së Malit të Zi. Po qe se kjo ndodhë, atëherë çështja e e pavarësisë së Kosovës do të jetë edhe më e theksuar. Gjithashtu ekzistonte mundësia se, duke marrë parasysh ndarjen e thellë të shoqërisë malaziasë rreth pavarësisë, do të arrihet një kompromis i përkohëshëm me Serbinë për një konfederatë të gjërë gjatë një kohe të caktuar. Çkado që të ndodhë, duhet të ketë bashkëpunim brenda ish Jugosllavisë si dhe në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Mirëpo, çështja e statusit përfundimtar të Kosovës nuk duhet të mbetet peng e zhvillimeve në pjesët e tjera të Jugosllavisë. Ky është një ndër mësimet e dekadës së kaluar; është kërkuar nga shqiptarët e Kosovës që t’i suspendojnë kërkesat e tyre përderisa problemet në Kroaci dhe Bosnje zgjidhen, që lejoj zhvillimin e pakënaqësive. Në Raport, Komisioni argumentoj se edhe

në rast të demokrazimit të vendeve tjera të Jugosllavisë do të ishte megjithatë e nevojshme të refuzohet ky opcion sepse, pas të gjithë asaj që shqiptarët e Kosovës kanë përjetuar në duart e autoriteteve Jugosllave gjatë më se dekadë, është e pa arsyeshme të pritet nga ata që të pranojnë të jenë ndër çfarëdo autoriteti Jugosllav, sado simbolik. Ky argument ende vlen. Definitivisht, tani që Kosova , në çdo aspekt praktik, është larguar nga kontrolla e sistemit legal edhe administrativ serb, është joreale të pritet se shqiptarët e Kosovës do të jenë sërish të gathshëm ta pranojnë prezencën e zyrtarëve serb, të paguajnë taksat Beogradit apo të kërkojnë pasaporta nga një shtet që e ka dëbuar gjysmën e tyre, duke ia shkatërruar letrat e identifikimit për tu siguruar se lidhja në mes te dyve është e shkëputur përgjithmonë, përkundër faktit se nëse njerëz të tjerë janë, së paku tani për tani, në pushtet.

**PAVARËSIA E KUSHTËZUAR** \* Sipas mendimit të Komisionit, propozimi për pavarësi të kushtëzuar vazhdon të jetë opcioni më i preferuar. Pasiqë disa faktorë ndërkombëtar duket se besojnë se vetqeverisja e krijuar nga principet kushtetuese të majit 2001 do të thotë pavarësi të kushtëzuar, në fakt nëse jo në emër, është me rëndësi të dallojmë në mes të vetqeverisjes ndër UNMIK-un dhe pavarësisë së kushtëzuar. Sipas kornizës së re kushtetuese, administrata e KB-së mban për vete të drejta të detajizuara të mbikqyrjes mbi programin e politikës së brendshme, policisë dhe gjykatës, si dhe të të gjitha marrëdhënieve ndërkombëtare. Këto fuçi më shumë i përngjajnë fuçive gjysëm mbretërore, që i përkasin një të varuri kolonial, se sa një populli vetqeverisës. Sipas idesë së Komisionit mbi pavarësinë e kushtëzuar, fuqitë mbi programin e politikës së brendshme që tani janë të rezervuara për PSSG do të transferoheshin progresivisht tek qeveria kosovare; në fund Kosova do të jetë e pavarur, sado e kushtëzuar, jashtë RFJ-së. Nuk ekziston asnjë arsye koherente se pse vetë kosovarët nuk mund të kenë kontrollë mbi paramentrat financiar dhe programor të buxhetit të tyre, sidomos pasi që më shumë se 70 % e të ardhurave administra-

tive të provincës mbledhen nga brenda, e nuk vijnë nga burimet ndërkombëtare. Gjithashtu, Komisioni nuk sheh asnjë arsye të bindshme se pse qeveria kosovare nuk mund të ketë kontrollë mbi çështjet si dogana, gjykata, shërbimi policor, prona shoqërore dhe shtetërore, hekurudha dhe trasnporti, aviacioni civil, drejtorati i pasurisë banesore dhe pronës, pronës komerciale, kufijtë komunal, rregullimi i armëve të zjarrit- pra, një numër të madh të fuçive të rezervuara për DPSG-së nën Kapitullin 8.1, seksionet a-z, dhe 8.2, si dhe fuçitë residuale të dhëna DPSG-së sipas Kapitullit 12. Nëse nuk ekziston ndonjë arsye e mirë që këto fuçi t'i mohohen qeverisë Kosovare, Komisioni parasheh fillimin e një lufte për t'i fituar ato.

Përveç fuçive të politikës së brendshme, të përshkruara më lartë, Komisioni beson se qeveria Kosovare duhet ta ketë edhe fuçinë të negociojë me dhe të bëjë prezentime para faktorit ndërkombëtar të sigurimit, KFOR-it, dhe të hyjë në negociata me agjencionet ndërkombëtare dhe qeveritë e huaja. Është posaçërisht me rëndësi që qeveria e re kosovare të zhvillojë raporte paqësore me të gjithë fqinjët e saj, sidomos me Maqedoninë dhe Serbinë. Po qe se marrëdhëniet ndërkombëtare të entitetit të ri mbesin ekskluzivisht në duart e DPSG-së, kosovarëve nuk do t'i mbetë asnjë nxitje që të sillen në mënyrë të ndërgjegjshme ndaj fqinjëve të tyre.

Atëherë, cilat duhet të ishin kufijtë e imponuar të kësaj vetqeverisjeje? Kushtet specifike për pavarësi do të ishin rezultat i një procesi të mendimit brenda Kosovës dhe me fqinjët e saj. Komisioni propozon, si pikë fillestare, këto katër kushte:

- 1 *Braktisjen eksplite të çfarëdo ndërrimit të kufijve d.m.th braktisja eksplicite e projektit të Shqipërisë së Madhe ose madje edhe të Kosovës së Madhe (duke përfshirë këtu p.sh. Luginën e Preshevës dhe Maqedoninë perëndimore). Me fjalë të tjera, liderët politik kosovarë duhet ta refuzojnë logjikën nacionaliste që thekson se grupet etnike duhet përputhur me kufinjë. Përdërisa ata mund t'i përkrahin të drejtat shqiptare në shtetet tjera dhe të*

bashkëpunojnë me fqinjët e tyre, ata duhet ta theksojnë besimin e tyre në mospërzjerje dhe në integritet teritorial.

- 2 *Garancion kushtetues për të drejtat e njeriut për të gjithë qytetarët e Kosovës.* Kjo do të thotë se minoritetet do të kanë qasje të barabartë dhe mundësi të barabartë pjesëmarrjeje në institucionet e Kosovës, dukë përfshirë gjykatën, shërbimin policor dhe posteve të fituara në zgjedhje, si dhe të drejtat e mbrojtura internacionalisht mbi shërbimet qeveritare dhe arsimimin të gjuhën e tyre. Një garancion i tillë kushtetues duhet të jetë më shumë se fjalë në letër: ai duhet të asimilohet në mendimin dhe sjelljen e jetës politike kosovare. Duhet që të ketë përpjekje të mirëfillta drejt kooperimit, dialogut dhe pajtimit ndërmejt grupeve të ndryshme në Kosovë. Posaçërisht, duhet synuar drejt krijimit të kushteve ndër të cilat serbët që e kanë braktisur Kosovën ndijnë se mund të kthehen në Kosovë, po qe se e dëshirojnë atë, dhe t'i mundësohet minoriteteve që mbesin në Kosovë pjesëmarrje në shoqëri.
- 3 *Dorëheqja nga përdormi i dhunës si mjet për zgjidhjen mosmarrëveshjeve të brendshme ose të jashtme.* Duhet të ketë përpjekje të sinqerta, si nga liderët politik kosovar ashtu edhe nga shoqëria civile, për ndërtimin e kulturës kundër dhunës në Kosovë. Nuk mjafton vetëm të flitet kundër dhunës: duhet të shihen masat reale për pengimin dhe denimin e dhunës, si brenda Kosovës ashtu edhe jashtë saj. Liderët politik kosovar duhet qartas të hekin dorë nga çfarëdo përpjekje të përdorimit të dhunës për sigurimin e kërkesave shqiptare, dhe duhet që të distancohen qartë nga grupet si UÇPMB-js dhe UÇK-ja.
- 4 *Angazhimi për bashkëpunim regional, qeverisje regjionale dhe institucione të qëndrueshme regjionale.*

Mbikqyrja efektive e këtyre kushteve do të kërkonte prezencë të vazhdueshme ndërkombëtare në Kosovë, të ngarkuara me përgjegjësi të posaçme për mbrojtjen e kufijve dhe minoriteteve. Kosova është një shoqëri e ndarë, e cila do të kërkojë prezencë të

sigurisë ndërkombëtare dhe asistim ndërkombëtarë për një kohë të gjatë. Duhet që të ketë mekanizma institucional me anë të të cilave bashkësia ndërkombëtare mund të veprojë kur dhuna ndërshoqërore, ose shkelja e të drejtave të minoriteteve, cenojnë stabilitetin e provincës, dhe/ose kur qeveria e Kosovës tregohet e paaftë ose pa vullnet për të vepruar, ose që të ndalojë çfarëdo përzierje të armatosur në shtetet fqinje. Fuçitë e bashkësisë ndërkombëtare, të cilat mund të qëndrojnë me DPSG-në apo në ndonjë formë tjetër, duhet të kufizohen në sferën e mbrojtjes së minoriteteve, garantimin e drejtave individuale të njeriut dhe të integritetit të kufijve; dhe këto fuçi duhet të ushtrohen vetëm atëherë kur autoritetet vendore qartazi dështojnë t'i kryejnë detyrat e tyre kushtetuese. Në afat të gjatë, përderisa qeveria kosovare ta forcon kapacitetin e saj administrativ dhe politik, dhe përderisa situata në regjion bëhet më e pështatshme për paqë, duhet të jetë e mundur që roli i bashkësisë ndërkombëtare të zvogëlohet edhe më tej dhe që populli kosovar të marrë përsipër edhe me shumë përgjegjësi. Kjo është ardhmëria e paramenduar me idenë e pavarësisë së kushtëzuar. Ajo dallon mjaft nga vetqeverisja e kufizuar nën UNMIK-un.

Pavarësia e kushtëzuar është njëkohësisht qëllim edhe proces. Qëllimi është sovraniteti dhe pavarësia për popullin e Kosovës, në suazat e përcaktuara nga bashkësia ndërkombëtare- d.m.th me kusht se Kosova e respekton integritetin teritorial e fqinjëve të saj, mirëmbanë paqen e brendshme dhe respekton të drejtat e njeriut, dhe mundëson mbrojtjen e traditave dhe institucioneve të komuniteteve minoritare. Pavarësia e kushtëzuar nuk e anashkallon (në fakt, ajo e kërkon) zhvillimin e raporteve të afërta me fqinjët e Kosovës, sidomos me entitetin që do ta zëvendësoj RFJ-në. Por këto marrëdhënie të reja më së miri zhvillohen në baza vullnetare, nga pozita fillestare e pavarësisë sovrane. Gjithashtu, varet nga populli i Kosovës, në negociata të lira me fqinjët e saj, të vendosin se çfarë do të jenë këto raporte. Pavarësia e kushtëzuar është gjithashtu një proces i devolvimit progresiv, ndër të cilën fuçite që

momentalisht janë në duar të bashkësisë ndërkombëtare, ndërmjet DPSG-së, të transferohen progresivisht tek zyrtarët e zgjedhur vendor. Qëllimi i pavarësisë së kushtëzuar është që pushteti që është në duar të bashkësisë ndërkombëtare të devolvet sërish aty ku takon, te populli i Kosovës.

Ekzistojnë tri argumente kryesore që janë paraqitur kundër këtij propozimi. I pari mirret me çështjen e demokracisë në Serbi. Zyrtarët serbë dhe komentatorët ndërkombëtarë shpesh argumentohen se tani nuk është momenti i mirë për ta shqyrtuar çështjen e statusit të ardhëm të Kosovës, sepse kjo mund ta pengojë progresin serb drejt demokracisë- d.m.th së kjo çështje mund të shfrytëzohet nga politikanët ekstremist dhe mund ta largon vëmendjen nga punët e përditshme urgjente. Padyshim se Kosova e pavarur formalisht jashtë RFJ-së, sado e kushtëzuar, është diçka që vështirë mund të përbihet nga shumë serbë. Andaj është edhe me më shumë rëndësi që liderët shqiptarë të Kosovës të kontaktojnë me Beogradin dhe tani t'i fillojnë diskutimet rreth mënyrave për ndërtimin e një raporti të ri. Një diskutim i tillë duhet të përfshinë krijimin e kushteve për kthimin e refugjatëve, ruajtjen e vendeve më rëndësi historike serbe në Kosovë, kërkimin e të zhdukurve, shkëmbimin e të burgosurve si dhe të kooperimit ekonomik. Nga lufta ende mungojnë rreth 3000-4000 persona, shumica shqiptarë të Kosovës. Është një kërkesë legjitime e serbeve dhe e shqiptarëve të Kosovës që UNMIK-u dhe autoritetet e tjera relevante të harxhojnë më shumë energji dhe mjete për të kuptuar se çka ka ndodhur me ta. Shumica e tyre me gjasa janë të vdekur. Deri me tani gropimi si në Kosovë ashtu edhe në Serbi ka qenë tepër i ngadalshëm. Rreth 200-300 shqiptarë nga Kosova ende mbahen në burgje serbe si të burgosur politik. Qeveria në Beograd duhet t'i lëshon këta persona sa më parë. Ky është hapi i parë drejt pajtimit.

Komisioni mendon se shtyrja e çështjes së statusit të Kosovës do ta vështërsonte zgjidhjen e saj më vonë, jo vetëm në Kosovë por edhe në vet Serbi. Si me rastin e kooperimit me Tribunalin për

Krime Luftë, është më lehtë që të mirren vendimet e vështira tani, kur popullariteti i regjimit post-Milloshëviq është i madh, se më vonë kur zvogëlohet euforia. Pavarësia e kushtëzuar e Kosovës mund të shihet si çmimi për lirimin e demokracisë serbe nga deluzionet nacionaliste, duke e hapur rrugën drejt pajtimit me fqinjët e saj dhe prospektit të “kthimit në Evropë”. Pas një dekade të luftërave, shoqëria serbe është e lodhur dhe asaj i nevojitet “normaliteti”. Koshtunica mund t’u përdorë profilin e tij nationalist dhe madantin demokratik mirë, duke e bërë një kthesë të qartë prej kohës së Millosheviqit dhe të mitit mbi “ripushtimin serb të Kosovës”. Ekziston një tendencë në Serbi që 5 Tetori 2000 të trajtohet si Dita Zero; mirëpo Serbia duhet të ballafaqohet me të kaluarën e saj si parakusht për kthimin në “normalitet” dhe demokratizim brenda Serbisë, si dhe për kooperim regional.

Argumenti i dytë kundër pavarësisë së kushtëzuar është i ashtuquajtur i domino argumenti. Është thënë se pavarësia e kushtëzuar do të nxiste kërkesa për pavarësi në Mal të Zi dhe për particion në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Maqedoni, si dhe kërkesa brenda Serbisë në Vojvodinë dhe Sanxhak. Ekzistojnë katër argumente për refuzimin e këtij pohimi. Së pari, parakushtet për pavarësi të Kosovës, të shënuara më lartë, e përjashtojnë çdo provokim direkt nga Kosova; pra, dorëheqja nga logjika nacionaliste, refuzimi i dhunës dhe angazhimi për mosintervenim do të thonë se nuk do të kishte pasoja direkte për fqinjët e Kosovës, dhe mëturje, prezenca e vazhduar a bashkësisë ndërkombetare do ti garantonte këto kushte. Së dyti, pavarësia e Kosovës do ta largojë pasigurinë që rrjedh nga karakteri i përkohshëm i statusit të tashëm të Kosovës dhe do ta zvogëlonte shtytjen për të ndërruar faktet të terren, siç është thënë më lartë. Së treti, është me rëndësi ta theksojmë të drejtën normative për pavarësinë e Kosovës. Nga pikëpamja legale, argumenti për vetvendosjen e shqiptarëve të Kosovës rrjedh nga shkelja sistematike e te drejtave të njeriut gjatë një periudhe të gjatë kohore. Argumenti i njejtë nuk mund të përdoret nga serbët e Bosnjes apo nga shqiptarët e Maqedonisë.

Gjithsesi, cilido grup që ka fytyrë të thotë se situata e tyre mund të krahasohet me atë të shqiptarëve të Kosovës para 1999, siç u bë në Maqedoni, duhet të kritikohet rreptë. Së katërti, është vështirë të shohim se pse cilido nga opcionet alternative të propozuara nuk do ta shkaktonin domino efektin tek fqinjët e Kosovës. Si në rast të Serbisë, është me rëndësi që liderët politikë shqiptarë të fillojnë dialogun dhe kooperimin me fqinjët e tyre dhe t'i bindin ata për vullnetin e mirë dhe respektin që Kosova ka për integritetin e tyre.

Argumenti i tretë ka të bëjë me Këshillin e Sigurimit të KB-së, i cili është kundër çfarëdo ndërrimit të statusit të Kosovës. Është thënë se çfarëdo përpjekje që të largohemi nga Rezoluta 1244 e Këshillin e Sigurimit të KB-së do ta rezikonte kompromisin e arritur me Rusinë-që Kosova të mbetë brenda kufinjëve Jugosllav-gjë që ishte me rëndësi për t'iu afruar fundit të intevenimit ushtarak të NATO-s. Mirëpo, siç kemi thënë edhe më parë, situata momentale e Kosovës është e papranueshme. Rusia do të kundërshtone pavarësinë e Kosovës, por është e papapremendueshme se ajo do ta ndalonte zgjidhjen po qe se do të arrihej një marrëveshje paraprake rajonale. Andaj është edhe më me rëndësi që NATO-ja dhe BE-ja të bëjnë presion në qeveritë rajonale për arritjen e një marrëveshjeje të tillë, të bazuar në realitetet e reja.

Koncepti klasik i sovraniteti, që rrjedh nga shekulli i 19-të dhe i cili rallë është realizuar në praktikë, është ai i sovranitetit absolut teritorial. Në shekullin e 21-të, sovraniteti është patjetër i ndarë dhe varet nga marrëveshjet më një numër të madh të faktorëve ndërkombëtarë.

Në Ballkan, koncepti sovranitetit të shekullit 19-të, shpesh i theksuar nga liderët nationalist, është sinonim me pasiguri dhe rrezikun e rikëndellur për luftë. Një sovranitet vërtetë i sigurtë në Ballkan- dhe gjithkund në Evropë dhe botë- është ai që është i kushtëzuar nga marrëveshjet ndërkombëtare. Sa i përket Kosovës, sovraniteti i kushtëzuar është mënyra e vetme që do ta bënte pavarësinë e Kosovës të pranueshme për fqinjët e saj dhe që do të rriste shkallën e sigurisë. Dallimi i rëndësishëm në mes të sovran-

itetit të propozuar për Kosovën dhe atij që gjendet tjetërkund në botë është se karakteri kushtëzues i sovranitetit kosovar nuk është zgjedhur me dëshirë, i cili duhet të jetë i qartë dhe i kodifikuar, dhe gjithashtu të jetë i mbikqyrur në mënyrë eksplicite. Me fjalë të tjera pavarësia e kushtëzuar në rast të Kosovës ka përmbajtje specifike. Ajo do të thotë se pavarësia mund të arrihet vetëm në bazë të disa kushteve të caktuara mirëmbajtja e te cilave, edhe pas pavarësisë, do të mbetet përgjegjësi e bashkësisë ndërkombëtare. Pra, sovraniteti do të jetë i mbikqyrur në mënyrë eksplicite.

## DREJT NJË PROGRESI RAJONAL

Si mund të arrihet kjo pavarësi e kushtëzuar? Një deklaratë e qartë nga bashkësia ndërkombëtare, sa më shpejtë pas zgjedhjeve të nëntorit, për angazhimin e saj drejt pavarësisë së kushtëzuar do ta parandalonte debatën destruktive me udhëheqësinë e posazgjedhur kosovare. Edhe pa kësi deklarate, liderët e ri kosovar munden ta caktojnë agjendën e tyre për një proces is cili do të çojë drejt pavarësisë. Ata munden të:

- Shprehin angazhimin e tyre për plotësimin e kushteve për pavarësi të cekura ne këtë tekst, sidomos dorëhqjen nga dhuna dhe respektin e tyre për integritet të kufijve;
- Fillojnë një proces të dialogut afatgjatë, brenda Kosovës dhe me fqinjët e saj, rreth mënyrave se si mund të plotësohen këto kushte. Ky dialog duhet që të inkadrojë të dy llojet e liderëve politik, d.m.th përfaqësuesit e zgjedhur si dhe shoqërinë civile. Dialogu posaçërisht i rëndësishëm është ai me RFJ-në, në mënyrë që si liderët ashtu edhe popullata e rëndomtë të kuptojë se Kosova nuk është më pjesë e RFJ-së por e cila dëshiron të bashkëpunon seriozisht rreth çështjeve siç janë mbrojtja e monumenteve historike dhe kthimi i refugjatëve;
- Negociojnë me UNMIK-un rreth një kornize të re kushtetuese, që gradualisht dhe progresivisht do ta transferonte fuçinë

momentale të DPSG-së tek qeveria kosovare, përderisa ajo i ndërton kapacitetet e saja administrative dhe organizative.

Procesi i dialogut duhet të mirret si pjesë e një procesi më të gjërë rajonal, të cilin bashkësia ndërkombëtare udhëheq me qëllim që të mundësojë zgjidhje e jo t'a imponon ato. Kohëve të fundit ka një interesim të konsiderueshëm për mbajtjen e një konference të re për zgjidhjen përfundimtare e çështjeve të pazgjidhura në rajon, që ka për qëllim eliminimin e pasojave ngjithëse të pasigurisë. Mirëpo, në dekadën e fundit janë mbajtur shumë konferenca ndërkombëtare- Konferenca e Londrës më 1992, Dejtoni, Rambujeja janë disa nga këto- të cilat dështuan ose në arritjen e vendimit përfundimtar, ose në implementimin e këtyre vendimeve. Problemi qenësor është se ky lloj i konferencës elite dështon në shqyrtimin e çështjes kryesore: atë të raportit në mes të vendimeve formale (rreth sovranitetit, kufijve ose kushtetutës) dhe jetës së përditshme. Shumica e ish-Jugosllavëve kanë përjetuar regjime tejet të centralizuara dhe autoritare me udhëheqje nga lartë dhe kjo, pjesërisht, e spjegon preokupimin me çështje formale. Mirëpo, frustrimet që dalin nga jeta së përditshme janë ato që i krijojnë rrethanat bazike për nacionalizmin e masave. Pyetja kryesore është se në çfarë mënyre të decentralizohet dhe demokratizohet jeta e përditshme, kështu që çështjet si sovraniteti dhe kufijtë të kenë më pak rëndësi. Duke marrë parasysh këtë mënyrë të mendimit, çdo qasje drejt marrëveshjes finale do të duhej të kombinonte vendimet afatgjata rreth kornizës formale me raporte të ndërruara në mes të kornizës formale dhe proceseve joformale-d.m.th të krijohet një natyrë të ndërruar e sovranitetit ku kufijtë dhe simbolet janë më pak të rëndësishme. Që koncepti i ndryshuar i sovranitetit të jetësohet në afat të gjatë duhet që qasja e marrëveshjes të jetë më pak e diktuar nga lartë; do të ketë nevojë më të madhe të inkuadrimit të p.sh. grupeve civile dhe komunave në procesin e arritjes së marrëveshjes përfundimtare.

Një proces regional i këtij tipi, i cili mund të kulminon më një

konferencë dhe marrëveshje përfundimtare, është i ngjajshëm më atë që propozon Ministri i Jashtëm i Jugosllavisë, Goran Svilanoviq, për një Proces Ballkanik të Helsinkit. Një proces i tillë do të duhej ti kombinonte tre elemente:

- Çështjet klasike të Helsinkit- kufijtë dhe drejtat e minoriteteve;
- Çështjet e reja që kanë të bëjnë me raportin në mes vendimeve formale (kufijtë, kushtetutat, simbolet e sovranitetit) dhe jetës së përditshme;

Deri më tani, kjo është diskutuar kryesisht në lidhje me çështjet e ekonomike; andaj, korniza e Paktit të Stabilitetit i ka kushtuar rëndësi të veçantë masave programatike si liberalizimit të tregut dhe infrastrukturës së përbashkët. Por çështjet tjera janë poashtu me rëndësi. Kooperimi i Këshilli Nordik mund të ofron një model për këso qasje. Çështjet për diskutim mund të përfshijnë këto pika:

*Pajtimin.* Pengesa më e madhe për integrimin e serbëve dhe shqiptarëve në shoqërinë Kosovare, statusi përfundimtar i Kosovës, apo integrimi i sllavëve dhe shqiptarëve në shoqërinë maqedonase është pasojë e mungesës të një tregimi të përbashkët rreth shkkakut për ngjarjet e zhvilluara në dekadën se fundit, për të pajtohen anët në konflikt dhe e që i tejkalon verzionet kundërshtuese që ekzistojnë momentalisht. Tregimet garuese të viktimizimit dhe kronologjitë jokonsistente janë pengesa për pajtim të gjërë regjional. Ekzistojnë propozime për një Komision të së Vertëtës dhe Pajtimit për Serbi dhe Bosnje. Mirëpo, ekziston rreziku se, po qe se nuk sigurohet pjesëmarrja e popullit nga tërë rajoni, puna e këtyre Komisioneve do të përfundojë, në rastin më të mirë, më tregime gjysëm të vërteta ose, në rast më të keq, me tregime rivale kombëtare. Për këtë arsye një proces regjional është shumë i rëndësishëm. Një proces i tillë do të duhej të mirret edhe me masat për ndërtimin e besimit, si p.sh. me kërkimin e të zhdukurve dhe lirim të ndërsejllë e të burgosurve.

*Trashëgiminë Kulturore.* Në Beograd, Komisioni është njoftuar me shkatërrimin e trashëgimisë kulturore serbe në Kosovë gjatë vitit të fundit. Në Banja Lukë në maj 2001 janë mbajtur demonstrata kundër përpjekjeve të muslimanëve për të rindërtuar xhamitë e shkatërruara gjatë luftës. Ky rajon është i pasur me histori, dhe monumentet e kombeve dhe feve të ndryshme janë pjesë e trashëgimisë së gjërë Ballkanike. Andaj duhet diskutuar mbi mënyrat e mbrojtjes kulturore të tërë rajonit. Angazhimi individual i shteteve për ta mbrojtur pronën e saj, në bashkëpunim me fqinjët e tyre, është test i pjekurisë së tyre politike.

*Sigurinë.* Një strukturë e integruar për siguri që përfshinë tërë rajonin, me pjesëmarrje të KFOR-it dhe forcave vendore, mund të jetë një mënyrë për profesionalizimin e forcave që njëkohësisht do të parandalonte konfliktet. Bashkëpunimi në mes të KFOR-it dhe forcave serbe në Luginën e Preshevës mund të paraqet një model për bashkëpunime të ngjajshme. Këta shembuj nuk janë gjithëpërfshirës; çështje tjera si shëndetësia, arsimi dhe mediat mund t'i shtohen listës.

- Propozimet për institucionalizim e kornizës rajonale. Momentalisht ekziston një numër i madh i iniciativave rajonale- Pakti i Stabilitetit, Marrëveshjet e Stabilizimit dhe Asocimit me BE-në, marrëveshja e Partneritetit me NATO-n si dhe llojet e ndryshme të pjesëmarrjes ndërkombëtare- UNMIK-u, Zyra e Përfaqësuesit të Lartë në Bosnje dhe prezenca e NATO-s në Shqipëri dhe Maqedoni. Çka mungon është një qasje e qartë politike dhe angazhimi konstant politik në rajon. Për shembull Pakti i Stabilitetit, që filloj më shumë solemnitet në Sarajevë në verë 1999, u përcoll me shpresa të mëdhaja por që nga atëherë ka humbur momentumin e saj politik. Do të ishte më rëndësi që të diskutohen mënyrat të cilat do t'i përmbledhnin të gjitha këto iniciativa në një kornizë të vetme Ballkanike, të lidhur me BE-në, me krye-

qendër në rajon, ndoshta në Sarajevë. Një proces i tillë rajonal kërkon autorizim nga niveli më i lartë, i qeverive rajonale si dhe nga bashkësia ndërkombëtare, por i cili duhet ta parashtron një kornizë për një proces “nga poshtë”, ku do të kyçeshin të gjitha nivelet e shoqërisë në një diskutim gjithëpërfshirës. Në shkallë të vogël, negociatat rreth Luginës së Preshevës janë një model i procesit të tillë.

## KONKLUKDIMI

Raporti ynë vendosi se në disa raste të jashtëzakonshme, që barazohen me një katastrofë humanitare të pritur ose në zhvillim, do të arsyetohej përdorimi i forcave ndërkombëtare pa autorizimin e Kombeve të Bashkuara. Në rrethana të tilla është qenësore që përdorimi i dhunës të jetë në përputhje të rreptë me një seri të rregullave të shenuara në kornizën e principeve të hartuara për cilindo rast të intervenimit humanitar (Përmbajtjen e kësaj kornize mund ta lexoni në Raportin për Kosovën, faqe 193-5). Raporti gjithashtu përkrah shtojcën se, edhe nëse intervenimi humanitar është i përkrahur nga autoriteti i KB-së, ekziston një obligim ndërkombëtar që këto rregulla të respektohen.

Komisioni është i mendimit se ngjarjet në Kosovë që nga viti 1999 na japin të drejtën t'a ritheksojmë pozitën tonë, duke pasur tani edhe vetbesimin e fituar nga përvoja ekzistuese. Që këtyre rregullave, ose një formulimi pak të ndryshuar, t'i forcohet statusi është me rëndësi që ato të jenë edhe formalisht të përvehtësuara nga organet e KB-së, dhe sidomos nga Këshilli i Sigurimit dhe Kuvendi i Përgjithshëm. Mund të jetë e dobishme t'i besohet Komisionit Ndërkombëtar Ligjor detyra e zhvillimit të një teksti autoritativ në bazë të kornizës së principeve tona.

Përvoja e fituar pas botimit të Raportit ilustron rëndësinë (dhe pamjaftueshmërinë) e kornizës tonë rreth obligimeve të përfaqësuesve ndërkombëtarë edhe pas intervenimit në Kosovë. Rëndësi

të veçantë janë aplikimi i Principeve 9 dhe 11 të kornizës. Principi 9 thotë se: “ligji i luftës dhe ai ndërkombëtar humanitar duhet të respektohet edhe më rreptësisht se në operacionet e rëndomta ushtarake. Kjo vlen për të gjitha fazat e operacionit ushtarak, duke përfshirë këtu edhe stacionimin eventual pas armëpushimit.” Komisioni mendon se KFOR-in duhet lavduar për respektimin e ligjeve të lartëpërmendura gjatë periudhës së deritanishme. Mirëpo, KFOR-i dhe UNMIK-u nuk i kanë kushtuar kujdes të mjaftueshëm mbrojtjes së minoriteteve të rezikuara, sidomos në fazat e para të stacionimit, duke lejuar procesin që ndonjëherë quhet “pastrimi i anasjelltë etnik”, me ç’rast në Kosovë është abuzuar minoriteti serb dhe aleatët të saj, sidomos romët. Që nga fillimi është dashur që kujdes më të madh t’i kushtohet mbrojtjes së civilëve në Kosovë, dhe të theksohet respekti për ligj. Gjithashtu, kufijtë është dashur të sigurohen më mirë, si dhe të parandalohet furnizimi i grupeve të armatosura në ZTS në Serbi dhe Maqedoni. Duke marrë parasysh këto zhvillime, fjalja e dytë e Principit 9 duhet të reformulohet që të thotë: “Kjo vlen për të gjitha fazat e operacionit ushtarak, duke përfshirë këtu edhe stacionimin eventual pas armëpushimit, dhe imponon detyrë të veçantë mbi forcat ushtarake, dhe homologët të saj administrativ, që t’i japin prioritet maksimal mbrojtjes së segmenteve të rezikuara të popullatës civile, përfshirë këtu edhe parandalimin e akteve hakmarrëse dhe denuese.” Dështimi në përbushjen e kësaj detyre definimitivisht e ka zvogëluar legjitimitetin e intervenimit të NATO-s, por jo në atë shkallë që Komisioni të mos përkrahë më intervenimin e vitit 1999 pasi që ky intervenim rezultoi në përfundimin një katastrofe humanitare, e cila pa intevenimin e NATO-s me të gjitha gjasat do të rezultonte në një abuzim masiv dhe të vazhdueshëm të popullatës shumicë që jeton në Kosovë.

Në përgjithësi, Komisioni konkludon se zhvillimet e fundit në Ballkan e theksojnë rëndësinë e propozimeve të shënuara në Raportin për Kosovën. Rrënja e Milosheviqit nga pushteti, larg

asaj që ta shtyejë zgjidhjen përfundimtare të konfliktit kosovar, ka dhënë mundësinë për një marrëveshje në mes të Serbisë dhe Kosovës mbi statusin final të Kosovës. Mirëpo, është e qartë se bashkësia ndërkombëtare dhe sidomos fuçitë perëndimore të cilat e kanë përkrahur intervenimin, dhe që rrjedhimisht kanë një obligim të konsiderueshëm, duhen të bëjnë presion në këta dy partnerë që ta shfrytëzojnë këtë rast. Gjithsesi, ekziston rreziku që fuçitë perëndimore t'i përsërisin gabimet e tyre historike të bëra ndaj Kosovës në fillim të 1990-tave: duke mos e përkrahur rezistencën paqësore kundër opresionit serb dhe duke e përjashtuar çështjen e Kosovës nga negociatat e Dejtonit, bashkësia ndërkombëtare lejoj që konflikti të keqësohet dhe, metutje, dërgoj porosinë kosovarëve se botës se jashtme i bën përshtypje vetëm dhuna. Kjo rezultoi në krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kjo situatë mund të përsëritet. Qeveritë perëndimore duhet t'i japin zgjidhjes së statusit të Kosovës të njejtën rëndësi që e pat arrestimi i Millosheviqit pas rrënies së tij nga pushteti. Të njëjtat argumente kundër shqyrtimit të çështjes së Kosovës janë bërë edhe kundër insistimit të Perëndimit që Millosheviqi të transferohet në Hagë. Mirëpo, u pa se transferimi i Millosheviqit ishte një hap i konsiderueshëm drejt demokratizimit të Serbisë. Është shumë e mundur se vendimi mbi statusin përfundimtar të Kosovës mund të ketë pasoja pozitive, përderisa moszgjidhja e statusit të Kosovës që tani ka pasoja negative. Pasiguria ka kontribuar drejt dhunës si në Kosovë ashtu edhe në shtetet fqinje. Kjo situatë gjithashtu i jep liderëve politik kosovar pak motivim ta bëjnë atë në çka bashkësia ndërkombëtare ka dështuar: pra ta krijojë një gjendje të sigurtë të brendshme dhe të jashtme.

Zgjedhjet kosovare të nëntorit 2001 ofrojnë edhe një rast për pa propozuar pavarësinë e kushtëzuar. Bashkësia ndërkombëtare duhet të parandalon konfliktet e ardhshme duke e hapur çështjen e pavarësisë. Ndërsa, udhëheqësia politike kosovare duhet ta shfrytëzon muajin e mjalit që pason pas zgjedhjeve për të filluar implementimin e kushteve të marrëveshjes.

Komisioni ende mendon se intervenimi i NATO-s në Kosovë ishte legjitim. Mirëpo, legjitimiteti i intervenimit mund të cenohet nga dështimi i bashkësisë ndërkombëtare për tu angazhuar fuçimsht për ardhmërinë e Kosovës dhe të rajonit, pra të marrin inicitativa politike me përkrahje adekuate ushtarake dhe ekonomike që janë të nevojshme për një zgjidhje afatgjate. Mendimi ynë është se këto masa nënkuptohen me angazhimin e bashkësisë ndërkombëtare për pavarësinë e kushtëzuar të Kosovës, dhe për një proces të dialogut dhe të bashkëpunimit të rajon. Të gjithë ata që marrin pjesë në intervenimin e NATO-s kanë përgjegjësi që të sigurojnë se legjitimiteti i këtij intervenimi përkrahet me një qasje kontinuale konstruktive.

- 1 Anëtarët e Komisionit biseduan me Ivan Benderin, këshilltarin i Zv-Kryeministrit Qvoviç, i cili ishte negocijues i marrëveshjes. Benderi është anëtar i ri i qeverisë; ai ishte përpara student aktivist i cili i kishte përkrahur studentët kosovarë në kampanjën e tyre për implementimin e Marrëveshjes për Arsim në vjeshtë të vitit 1997 (shih Raporti për Kosovën, Kapitulli I). Atë e kishte dërguar Qvoviç në rajon, ku ai kaloi disa muaj duke shetitur fshatrat, duke biseduar për problemet e popullatës lokale dhe duke fituar besimin e tyre. Ai madje i ka ndihmuar atyre edhe gjatë punës me bagëti. Kjo qasje prej masave deri te elitat padyshim ka vendosur themelet e marrëveshjes.
- 2 Referohuni në Raportin e Human Rights Watch për Maqedoninë: shih [www.hrw.org](http://www.hrw.org)
- 3 Shih Iniciativën për Stabilitet në Mal të Zi: “Retorika dhe reforma: një studim i ndërtimit të institucioneve në Mal të Zi, 1998-2001”, dalë me datën 1 qershor 2001 në Podgoricë dhe Berlin. Teksti mund të gjindet në: [www.esiweb.org](http://www.esiweb.org)
- 4 Flaka Surroi, e cila përfaqësohte shoqërinë civile në komisionin punues për kornizën kushtetuese, dha dorëheqje. Arsytet, të cilat ajo i jep në letrën e saj dorëheqëse, janë këto: Së pari, Korniza Kushtetuese është aprovuar përderisa populli i Kosovës nuk është pyetur fare për te. Kroniza është shkruar nga një grup i profesionistëve dhe është diskutuar vetëm me partitë politike. Nuk duhet cekur fare se shoqëria civile ishte plotësisht e injoruar. Mëtuqje, sipas provizioneve të këtij dokumenti, Kosova do t'i zgjedhë strukturat vetqeverisëse që do të kenë autoritet tejet të vogël. Përfundimisht, unë nuk mund të jem anëtare e një ekipi i cili do t'i disenjon rregullat për zgjedhjet të cilat do t'i paraprijnë krijimin e një sistemi sipas të cilit gati i gjithë pushteti do të jetë i koncentruar në një njeri dhe asistentët e tij; rregullat për zgjedhjejn e asamblesë forca legjislativë e së cilës gjithmonë do të jetë e rezikuar nga vetoja; dhe rregullat për vendosjen e një presidenti që do të ndajë shpërblime dhe shpreh falënderim.”
- 5 Mendim i tillë është shprehur nga Ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Paskal Milo: “Ne dëshirojmë që këta kufij të jenë më pak të rëndësishëm. Ne mendojmë t'i bashkangjitemi BE-së dhe andaj dëshirojmë që ky të jetë një regjion i bashkëpunimit. Filozofia e nacionalizmit, ekstremizmit është në kundërshtim me principet e Evropës së bashkuar. Nacionalistët dhe ekstremistët dëshirojnë t'i mbyllin kufijtë dhe të krijojnë shtete të vogla kombëtare. Për ne kjo do të ishte kudërproduktive” (Cituar nga Tim Judah, “Shqipëria e Madhe?” në zhurnalin Survival Vol 43, No 2, 2001, faqe I6).



## ACRONYMS

DPA	Radical Albanian Party in Macedonia
EU	European Union
FRY	Federal Republic of Yugoslavia
GDP	Gross Domestic Product
GSZ	Ground Safety Zone on border of Kosovo
HDZ	Croatian Democratic Union
ICTY	International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia
KFOR	Kosovo (International Security) Force
KLA	Kosovo Liberation Army
LPK	Levizja Popullare e Kosoves
NATO	North Atlantic Treaty Organisation
NLA	The National Liberation Army in Macedonia
SDA	Party of Democratic Action, in Bosnia Herzegovina
SRS	Special Representative of the Secretary General
UCPMB	Liberation Army of Presevo, Medvedja and Bujanovac
UNMIK	United Nations Interim Administration Mission in Kosovo
VMRO	Macedonian radical Slav nationalist party

## BACKGROUND ABOUT THE COMMISSION

The initiative to form the Independent International Commission on Kosovo was taken by the Prime Minister of Sweden, Mr Göran Persson, who concerned by the absence of independent analysis of the conflict in Kosovo and any real attempt to research the lessons to be learnt from the conflict. The Secretary-General of the United Nations, Mr. Kofi Annan, with whom he informally canvassed the idea, endorsed the project.

Prime Minister Persson announced the establishment of the Commission on August 6, 1999. Direct involvement by the Swedish government in the Commission extended only to the invitation to Justice Richard Goldstone of South Africa and to Mr. Carl Tham, Secretary-General of the Olof Palme International Center in Stockholm to act as chairman and co-chairman respectively.

Appointment of the remaining 11 members of the Commission was made after invitations had been extended to particular individuals by Justice Goldstone and Mr Tham. Given the sensitive nature of the initiative—the very many international actors who stood to be scrutinized by the Commission—selection was made on the basis of known expertise and with due regard for the gender and geographical composition of the Commission.

The Commission members have convened six times:  
September 1999 – Stockholm  
December 1999 – New York  
April 2000 – Budapest  
June 2000 – Florence  
August 2000 – Johannesburg  
September 2001 – Stockholm

After the launching of the report the Commission has had 20 seminars in Northern America, Europe and Japan. It has also had consultations with Governments including the United States and The Federal Republic of Yugoslavia.

### **MISSION STATEMENT FROM 21 SEPTEMBER 1999**

The Independent International Commission on Kosovo will examine key developments prior to, during and after the Kosovo war, including systematic violations of human rights in the region. The Commission will present a detailed, objective analysis of the options that were available to the international community to cope with the crisis. It will focus on the origins of the Kosovo crisis, the diplomatic efforts to end the conflict, the role of the United Nations and Nato's decision to intervene militarily. It will examine the resulting refugee crisis including the responses of the international community to resolve the crisis. The effect of the conflict on regional and other states will also be examined. Furthermore, the Commission will assess the role of humanitarian workers, NGOs and the media during the Kosovo war. Finally, the Commission will identify the norms of international law and diplomacy brought to the fore by the Kosovo war and the adequacy of present norms and institutions in preventing or responding to comparable crisis in the future.

In addition the Commission will take up: The future status of Kosovo, Lessons learned for Kosovo, and Lessons learned for the future.

## THE MEMBERS OF THE COMMISSION

*Chairman* Richard Goldstone, South Africa

*Co-chairman* Carl Tham, Sweden

*Members:*

Grâce d'Almeida, Benin <sup>1</sup>

Hanan Ashrawi, Palestine <sup>2</sup>

Akiko Domoto, Japan

Richard Falk, USA

Oleg Grinevsky, Russia <sup>3</sup>

Michael Ignatieff, Canada

Mary Kaldor, UK

Martha Minow, USA

Jacques Rupnik, France

Theo Sommer, Germany

Jan Urban, the Czech Republic

*Assisting the Commission:*

Mark Ellis, legal advisor <sup>4</sup>

Pia Övelius, director

Anki Wood, press

Liam Mahony, editing <sup>4</sup>

Nicole Fritz <sup>4</sup>, Estelle Dehon <sup>4</sup> and Tung Chan <sup>4</sup>

Statistical team in Washington: Scott Carlsson <sup>4</sup>,

Charles Rudnick <sup>4</sup>, Randy Clark <sup>4</sup>, Wendy Betts <sup>4</sup>

The Commission extends its warm thanks to all the people who have made the Kosovo Report and the Follow-up possible.

---

1 Grâce d'Alemlida was unfortunately not able to participate in the work with the Follow-up due to other pressing engagements.

2 Unfortunately commitments to peace initiatives in the Middle East has prevented Dr. Ashrawi from participating in more than the first of the Commission's meetings and is therefore, not associated with the report.

3 Unfortunately ill-health prevented Ambassador Grinevsky from participating in more than the first of the Commission's meetings and he is not associated with the report.

4 Only the Kosovo Report.

## **FINANCIAL AND OTHER CONTRIBUTIONS**

A large financial contribution came from the Government of Sweden. This has been complemented by financial contributions from the Government of Canada, the Ford Foundation, the Carnegie Foundation, the Sasakawa Peace Foundation. Contributions by way of hosting Commission meetings and holding seminars for the Commission have been made by the Swedish Cooperative Union, New York University School of Law, the Carnegie Endowment for Peace, the Soros Foundation, the Central European University, ABA/CEELI, the United States Institute for Peace, the University of the Witwatersrand, and South African Institute of International Affairs

